



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE

**RAPORT VJETOR I KONSULTIMIT PUBLIK PËR VITIN 2025
PËR MINISTRINË E SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE**

1.Përmbledhja ekzekutive *(pasqyra e statistikave kryesore mbi konsultimet e kryera me mësimet e nxjerra, sfidat dhe mundësitë)*

Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2025 (këtu e në vijim MSHMS) ka miratuar dhe konsultuar nëpërmjet Regjistrit Elektronik të Njoftimit dhe Konsultimit Publik, takimeve dhe tryezave të konsultimit me aktorë jo qeveritarë si dhe aktivitete të tjera konsultative si vijon:

1. Projektvendimi “Për miratimin e Dokumentit Politik për Moshimin 2025-2030 dhe të Planit të Veprimit në zbatim të tij”.
2. Projektligji “Për barazinë gjinore”.
3. **Projektligji “Për Kujdesin alternativ në familje në Republikën e Shqipërisë”**
4. Projektligji “Për parandalimin dhe mbrojtjen ndaj dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje”.
5. Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8874, datë 29.3.2002, “Për kontrollin e lëndëve që përdoren për fabrikimin e paligjshëm të lëndëve narkotike dhe psikotrope”.

Indeksi i realizimit të procesit të konsultimit publik për vitin 2025 është 83%. Pasi 5 nga 6 akte të miratuara objekt i Ligjit 146/2014”Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”, janë konsultuar.

Vlerësohet se procesi i konsultimit publik për periudhën janar-dhjetor 2025 paraqet një trend të kënaqshëm duke patur parasysh një numër të madh aktorësh të përfshirë, sidomos nga organizata joqeveritare për shkak të ndjeshmërisë në lidhje me çështjet që trajtojnë projektaktet për konsultim.

Takimet konsultative janë zhvilluar nëpërmjet platformave të ndryshme, ndër to tryezat e përbashkëta dhe nëpërmjet e-mailit.

Në takime kanë marrë pjesë aktorë joqeveritarë të profileve të ndryshme si ekspertë të fushës, shoqata dhe organizata ndërkombëtare.

2.Analiza e konsultimeve të kryera

2.1.Numri i përgjithshëm i akteve për të cilat janë kryer konsultimet publike

Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale për vitin 2025, ka konsultuar nëpërmjet takimeve dhe tryezave të konsultimit me aktorë jo qeveritarë si dhe aktivitete të tjera konsultative 5 (pesë) akte.

2.1.1. Cili ishte numri i përgjithshëm i akteve të miratuara në një vit të caktuar?

Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale për vitin 2025 ka miratuar gjithsej 29 akte.

2.1.2. Sa akte janë konsultuar dhe sa jo?

Numri i akteve të cilat i janë nënshtruar procesit të konsultimit publik është 5 akte. Ndërsa një akt, Për disa shtesa në ligjin nr.7975, datë 26.7.1995, “Për barnat narkotike dhe lëndët psikotrope”, të ndryshuar, nuk është konsultuar.

2.1.3. Sa ligje me raporte VNR-je janë konsultuar?

Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale ka konsultuar projektligje me raporte VNR-je si me poshte:

- Projektligji “Për barazinë gjinore”.
- **Projektligji “Për Kujdesin alternativ në familje në Republikën e Shqipërisë”**
- Projektligji “Për parandalimin dhe mbrojtjen ndaj dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje”.

Ndërsa sipas përcaktimeve të pikës 45, në Kreun VI të VKM nr. 584, datë 28.08.2003 “Për miratimin e rregullores së Këshillit të Ministrave” të ndryshuar, aktet e mëposhtme nuk janë objekt i procesit të vlerësimit të ndikimit:

- Projektligji Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8874, datë 29.3.2002, “Për kontrollin e lëndëve që përdoren për fabrikimin e paligjshëm të lëndëve narkotike dhe psikotrope”.
- Projektvendimin “Për miratimin e Dokumentit Politik për Moshimin 2025-2030 dhe të Planit të Veprimtimit në zbatim të tij”, i cili nuk është objekt i procesit të vlerësimit të ndikimit, sipas përcaktimeve të pikës 45, në Kreun VI të VKM nr. 584, datë 28.08.2003 “Për miratimin e rregullores së Këshillit të Ministrave” të ndryshuar.

2.1.4. Për sa akte në a) Programin Analitik, b) PKIE, c) dokumente strategjike të sektorit, janë përdorur kriteret/përfjashtimet nga konsultimet publike? Cilat janë arsyet kryesore për të mos u konsultuar (nëse ka të tilla)?

Për aktet e parashikuara në Programin Analitik të vitit 2025, për 1 prej tyre janë përdorur kriteret e përfjashtimit nga konsultimi publik sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”, pasi nuk janë në listën shteruese për të cilën është i detyruar konsultimi publik. Aktet e përfjashtuara nga detyrimi për t’iu nënshtruar procesit të konsultimit publik nuk kanë qenë të parashikuara në PKIE apo të kenë lidhje me strategjitë kombëtare dhe sektoriale.

2.1.5. Cila ishte struktura e akteve të konsultuara (sa projektligje, VKM, udhëzime, etj.)?

Një projektvendim dhe 4 projektligje.

2.1.6. A është përmirësuar situata në krahasim me vitin e kaluar (cilësoni)?

Procesi i Konsultimit Publik për MSHMS-në duke e krahasuar me vitin e kaluar paraqet një trend në rritje, duke ju referuar numrit të pjesëmarrësve në konsultimet e projektakteve.

2.2. Metodat e konsultimit

2.2.1. Cilat ishin metodat më të përdorura të konsultimit? (Jepni numrin e konsultimeve të kryera për secilën metodë - regjistri elektronik, posta elektronike, faqe interneti, takime publike, komitete këshillimore, etj.)

1. Për procesin e konsultimit publik të Dokumentit Politik për Moshimin dhe Planit të Veprimit 2025-2030, janë përdorur metoda konsultimi si më poshtë:

- Takime konsultimi të drejtpërdrejta me anëtarët e Grupit Ndërinstitucional të Punës të ngritur me Urdhër Ministri 536/2024 me përfaqësues nga Ministritë dhe Institucionet;
- Takime konsultimi me grupet e ndryshme të interesit nga organizatat e shoqërisë civile aktive dhe kontribues në fushën e moshës së tretë, qendra ditore dhe rezidenciale të moshës së tretë si dhe përfaqësues të organizatës ndërkombëtare Fondi i Kombeve të Bashkuara për Popullsinë (UNFPA) dhe Qendrës Shqiptare për Popullsi dhe Zhvillim;
- Takime online konsultimi për dhënie kontributi me përfaqësues të Zyrave të Ndhmës dhe Shërbimeve Sociale të Njësive të Qeëverisjes Vendore (61 bashkitë e vendit);
- Korrespondenca përmes postës zyrtare elektronike (adresë E- mail: @shendetesia.gov.al), ndarë me të gjithë grupet e interesit të përfshirë në procesin e konsultimeve;
- Korrespondenca me shkresë zyrtare dërguar përfaqësuesve të institucioneve anëtarë të Grupit të punës sipas Urdhrit të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale Nr. 536/2024, për mendime mbi Planin e Moshimit.

2. Për procesin e konsultimit publik të projektligjit “Për barazinë gjinore” u perdoren metoda si më poshtë:

- Publikimi i projektligjit në Regjistrin Elektronik të Njoftimeve dhe Konsultimit Publik;
- Takime dhe Workshope konsultative të drejtpërdrejta dhe online, të realizuara me:
 - Anëtarë të Grupit të Punës/me Urdhër Ministri 39/2024;
 - Anëtarët e Grupit të interesit, përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile, aktive në fushën e barazisë gjinore;
 - Përfaqësues të organizatave ndërkombëtare dhe agjencive të UN në Shqipëri;
 - Përfaqësues nga sektori privat i grave dhe vajzave sipërmarrëse;
 - Përfaqësues nga Forumi i Mediave.

3. Për procesin e konsultimit publik të projektligjit “Për kujdesin alternativ në familje në Republikën e Shqipërisë” u përdorën metodat si më poshtë:

- Konsultimi publik nëpërmjet Regjistrit Elektronik të Konsultimeve Publike;

- Konsultim në kuadër të Urdhrit të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mirqenies Sociale, Urdhër Nr. 156, datë 28.03.2025 “Për ngritjen dhe funksionimin e grupit teknik të punës për hartimin e ndryshimeve të Ligjit nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë” dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, për hartimin e projektligjit të kujdesit alternativ dhe hartimin e planit të procesit të transformimit të qendrave rezidenciale të përkujdesit shoqëror për fëmijë 2025-2026”;

- Takim publik konsultues me aktorë joshitetëror Qershor – Shtator 2025.

- 6 takime (fizike dhe online) për diskutimin dhe këshillimin (qershor-shtator 2025) me shoqërinë civile dhe me aktorët e terrenit që operojnë në fushën e shërbimeve sociale.

- 10 takime konsultative të ngushta teknike me anëtarë të grupit të punës të ngritur me Urdhër të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mirqenies Sociale.

- Ekspertizë teknike ligjore, mbështetur nga UNICEF.

4. Për procesin e konsultimit publik të projektligjit “Për parandalimin dhe mbrojtjen ndaj dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje”, u përdorën metodat si më poshtë:

- Metodatat e konsultimit të përdorura për këtë projekt-akt janë takimet dhe tryezat konsultative, publikimi në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimin Publik, RENJKP dhe konsultimi me grupe ndër-institucionale;

- Takime fizikisht në mjediset e MSHMS-së;

- Takim me grupin Teknik ndër-institucional të Punës dhe përfaqësues nga ministrinë e linjës, INSTAT, Policia e Shtetit dhe Bashkia Tiranë;

- Takim me koordinatorët vendorë kundër dhunës në familje nga të 61 Njësitë e Vetëqeverisjes Vendorë;

- Takim me përfaqësues nga organizatat e shoqërisë civile;

- Takim me institucionet e teknologjisë dhe medias;

- Takim me përfaqësues të sistemit të drejtësisë;

- Takimi me grupin Teknik Ndër-institucional.

5. Projektligji Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8874, datë 29.3.2002, “Për kontrollin e lëndëve që përdoren për fabrikimin e paligjshëm të lëndëve narkotike dhe psikotrope”.

Është konsultuar nëpërmjet Regjistrit Elektronik të Njoftimit dhe Konsultimit Publik, palë të ndryshme interesi të fushës, qytetarët dhe publiku, patën mundësinë të informohen mbi projektaktin. Për këtë projektligj nuk ka patur komente nga procesi i konsultimit.

2.2.2 Cila metodë konsultimi gjeneroi numrin më të madh të komenteve?

- Në projektaktin për konsultimin publik të “Dokumentit Politik për Moshimin dhe Planit të Veprimit 2025-2030”, metodat e konsultimit që gjeneruan më shumë komente dhe u përfituan mendime dhe kontribute janë: takimet e drejtpërdrejta, emaillet dhe shkresat zyrtare

të dërguara nga institucionet anëtare të Grupit Ndërinstitucional të Punës dhe grupet e interesit që punojnë në fushën e mbrojtjes së të drejtave të tyre.

- Projektakti i Dokumentit Politik të Moshimit 2025-2030, iu dërgua për mendim me shkresë zyrtare 16 institucioneve, 9 institucion përfaqësues anëtarë të grupit të punës, si dhe : Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore, Bankës së Shqipërisë dhe Autoritetit të Mediave Audiovizive.
- Në projektaktin për konsultimin publik të projektligjit “Për barazinë Gjinore” metodat e konsultimit që gjeneruan më shumë komente dhe u përfituan mendime dhe kontribute janë: Takimet e drejtpërdrejta, korrespondenca elektronike me e-maile, dhe shkresat zyrtare të dërguara nga institucionet anëtare të Grupit të Punës dhe grupet e interesit që punojnë në fushën e barazisë gjinore, si edhe sugjerimet e përcjella nga shoqëria civile.
- Në projektaktin për konsultimin publik “Për propozimin e projektligjit “Për kujdesin alternativ në familje në Republikën e Shqipërisë” metodat që gjeneruan më shumë komente dhe u përfituan mendime dhe kontribute janë: takimet e drejtpërdrejta, emaillet dhe shkresat zyrtare të dërguara nga institucionet anëtare të Grupit të Punës dhe strukturat e pushtetit vendor të cilat operojnë në fushën e shërbimeve sociale.
- Në projektaktin për konsultimin publik “Për parandalimin dhe mbrojtjen ndaj dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje” metodat që gjeneruan më shumë komente dhe u përfituan mendime dhe kontribute janë: takimet e drejtpërdrejta, emaillet dhe shkresat zyrtare të dërguara nga institucionet anëtare të Grupit të Punës dhe strukturat e pushtetit vendor.
- Projektligji Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8874, datë 29.3.2002, “Për kontrollin e lëndëve që përdoren për fabrikimin e paligjshëm të lëndëve narkotike dhe psikotrope”. Nuk ka patur komente nga procesi i konsultimit.

2.2.3. A organizoi institucioni konsultime paraprake në fazat e hershme të hartimit? Nëse po, në sa raste?

Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale ka organizuar konsultime paraprake, me ekspertë të fushës, fokus grupe me palët e interesit dhe takime me përfaqësues organizatave ndërkombëtare dhe partnerët ndërkombëtarë në të paktën 4 raste.

2.3. Kohëzgjatja e konsultimeve

2.3.1. Sa konsultime ishin të hapura për 20 ditë pune siç kërkohet nga ligji? Cila ishte periudha më e gjatë apo më e shkurtër e kohëzgjatjes së konsultimeve?

Kohëzgjatja e konsultimeve publike ka zgjatur si më poshtë:

- Projektvendim, “Për miratimin e Dokumentit Politik për Moshimin 2025-2030 dhe të Planit të Veprimit në zbatim të tij” ka zgjatur nga data 05.12.2024 deri në datë 27.05.2025.
- Projektligji “Për barazinë Gjinore” ka zgjatur nga data 10.03.2025 deri në datë 07.04.2025.
- **Projektligji “Për Kujdesin alternativ në familje në Republikën e Shqipërisë”** ka zgjatur nga data 03.10.2025 deri në datë 31.10.2025.

- Projektligji “Për parandalimin dhe mbrojtjen ndaj dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje”, ka zgjatur nga data 06.10.2025 deri në datë 03.11.2025.
- Projektligji Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8874, datë 29.3.2002, “Për kontrollin e lëndëve që përdoren për fabrikimin e paligjshëm të lëndëve narkotike dhe psikotrope”, është konsultuar nga data 24.10.2025 -21.11.2025.

2.3.2. *Cila ishte kohëzgjatja mesatare e konsultimit?*

Kohëzgjatja mesatare akteve të konsultuara është 4.5 muaj.

Kohëzgjatja mesatare e konsultimit publik të projektaktit të “Dokumentit Politik të Moshimit dhe Planin e Veprimit 2025-2030 ka zgjatur mesatarisht 6 muaj.

Kohëzgjatja mesatare e konsultimit publik të projektaktit “Për barazinë Gjinore” ka zgjatur mesatarisht 8 muaj.

Kohëzgjatja mesatare e konsultimit publik të projektaktit “Për propozimin e projektligjit “Për kujdesin Alternativ në familje në Republikën e Shqipërisë” ka zgjatur mesatarisht 4 muaj.

Kohëzgjatja mesatare e konsultimit publik të projektaktit Për parandalimin dhe mbrojtjen ndaj dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje” ka zgjatur mesatarisht 3 muaj.

2.3.3.A është përmirësuar situata në krahasim me vitet e kaluara?

Krahasuar me një vit më parë kemi një gjenerim të konsiderueshëm të komenteve të ardhur nëpërmjet zhvillimit të takimeve dhe konsultimeve nëpër tryeza publike dhe takime me grupe dhe përfaqësues të përfshirë në procesin e konsultimit publik. Gjithashtu afatet e konsultimit publik të akteve të miratuara janë me kohështrirje të konsiderueshme.

2.4 *Palët e interesuara të përfshira*

2.4.1 *Sa aktorë të jashtëm, jo-qeveritarë morën pjesë për hartimin e akteve si anëtarë të caktuar të grupeve të punës/organeve këshillimore në vitin e caktuar?*

-**Në hartimin e projektaktit të Dokumentit Politik për Moshimin dhe Planin e Veprimit 2025-2030**, morën pjesë si anëtarë të jashtëm palë të interesuara si Autoriteti i Mediave Audiovizive, Banka e Shqipërisë dhe përfaqësues të shoqërisë civile.

- **Në hartimin e ligjit “Për barazinë Gjinore”** numri i paleve të përfshira morën pjesë si palë të interesuara, Autoriteti i Mediave Audiovizive, Banka e Shqipërisë dhe përfaqësues të shoqërisë civile.

Numri i pjesëmarrësve

-18 përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile dhe grupeve të interesit aktive në fushën e barazisë gjinore dhe të drejtave të njeriut;

-5 organizata ndërkombëtare (UNDP, UN Women, UNICEF, UNOPS, IOM).

-7 përfaqësues të ambasadave dhe agjencive ndërkombetare (Ambasada Suedeze, Ambasada e Vendeve të Ulta, Delegacioni i Bashkimit Evropian në Shqipëri, GIZ, OSCE, AICS, ADA);

Agjencia e Kombeve të Bashkuara UN Women, mundësuan mbështetjen me ekspertë në hartimin e projektligjit “Për barazinë gjinore”.

Në hartimin e ligjit “Për parandalimin dhe mbrojtjen ndaj dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje”, numri i palëve të përfshira:

-Numri i pjesëmarrësve rreth 118

- 61 kordinatorë vendore kundër dhunës në marrëdhëniet familjare;

- 24 organizata të shoqërisë civile;

- 12 institucione të pavarura;

- 7 institucione të shoqërisë së informacionit dhe mediave audiovizive;

- 2 institucione të sistemit të drejtësisë.

- Përfaqësues nga organizata ndërkombëtare.

- Përfaqësues nga sistemi gjyqësor.

- 61 kordinatorë vendore kundër dhunës në familje;

- 24 organizata të shoqërisë civile;

- Përfaqësues të ftuar në takimet e konsultimit parapërgatitore ishin edhe dy ekspertë, të cilët u mundësuan përmes mbështetjes së UNDP-së.

- Për hartimin e projektligjit “Për kujdesin alternativ në familje në Republikën e Shqipërisë” numri i palëve të përfshira;

-Përfaqësues nga CRCA

-Përfaqësues nga BETHANY

- Projektligji Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8874, datë 29.3.2002, “Për kontrollin e lëndëve që përdoren për fabrikimin e paligjshëm të lëndëve narkotike dhe psikotrope”, është konsultuar nga data 24.10.2025 -21.11.2025. Nuk ka patur aktorë të jashtëm të përfshirë në hartimin e projektaktit.

2.4.2 Cila ishte struktura e anëtarëve të jashtëm të grupeve të punës (ekspertë individualë, OSHC, kompani, etj.)


Në procesin e konsultimit publik për vitin 2025 morën pjesë aktorë të jashtëm të tipologjive të tillë si:

- Organizata të shoqërisë civile;
- Qendra ditore dhe rezidenciale; Biznese sociale;
- Organizata ndërkombëtare;

- Sistemi i pavarur gjyqësor;
- Ekspertë të pavarur.

2.4.3 *Sa palë të interesuara morën pjesë/dhanë komente në konsultimet e hapura të realizuara për projekt-aktet në vitin e caktuar?*

Në procesin e konsultimit publik të akteve të miratuara përgjatë vitit 2025, morën pjesë në takime konsultative dhe aktivitete të tjera konsultimi publik, 834 aktorë dhe palë interesi. Nga të cilët 47 dërguan komente dhe reagime.



2.4.4 *Cila ishte struktura e kontribuesve në konsultimet publike, sa persona, sa persona juridikë (ndërmarrje, shoqata, etj.)?*

Struktura e kontribuesëve:


- Organizata të shoqërisë civile;
- Ekspertë të mundësuar nga UNDP;
- Institucione publike në nivel qendror.

2.4.5 *A është përmirësuar situata në krahasim me vitet e kaluara?*

Situata në krahasim me vitet e kaluara paraqitet në rritje, nisur nga numri i madh i aktorëve të jashtëm të përfshirë në procesin e konsultimit publik.


2.5 Rekomandimet dhe komentet e marra

2.5.4. *Sa është numri i rekomandimeve dhe komenteve të marra gjithsej dhe mesatarja për çdo konsultim?*



2.5.5. Sa prej tyre u pranuan, u pranuan pjesërisht ose u refuzuan?

- Për Projektligjin “Për barazinë gjinore” numri i rekomandimeve dhe komenteve të marra gjithsej nga sugjerimet e bëra nga shoqëria civile dhe institucione ndërkombëtare janë 39, nga të cilat 32 janë pranuar plotësisht, 3 janë pranuar pjesërisht dhe 4 janë refuzuar.
- Për Projektligjin “Për Kujdesin alternativ në familje në Republikën e Shqipërisë” numri i rekomandimeve dhe komenteve që u pranuan 12 komente plotësisht, 7 rekomandime u refuzua dhe 6 rekomandime u pranuan pjesërisht. përgjatë konsultimit publik.
- Për Projektligjin “Për parandalimin dhe mbrojtjen ndaj dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje” numri i rekomandimeve dhe komenteve të marra nga organizatat e shoqërisë civile është 163, nga të cilat 122 janë pranuar plotësisht, 29 janë pranuar pjesërisht dhe 12 komente janë refuzuar.
- Projektvendimi për miratimin e Dokumentit Politik për Moshimin dhe planit të veprimit 2025-2030, ka grumbulluar gjithsej 22 komente nga të cilat 20 janë pranuar dhe 3 janë refuzuar.



2.5.6. Cila është tendenca nëse krahasohet me vitet e kaluara?

Duke e krahasuar me vitin e kaluar tendenca e komenteve dhe rekomandimeve mbetet në rritje . Referuar numrit të madh të komenteve të ardhura nepërmjet procesit konsultativ, dërguar me shkrim në formë shkresore dhe formë elektronike (sistemi elektronik i e-akteve).

2.5.7. Sa raporte të VNR-së janë ndryshuar/përditësuar në bazë të informacionit/të dhënave të marra gjatë konsultimit publik?

Raportet e VNR janë përditësuar mbas procesit të konsultimit publik.

2.6 Raportet mbi rezultatet e konsultimit

2.6.8. Sa raporte konsultimi publikoi institucioni?

Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale ka publikuar raportet e konsultimit publik për të gjitha aktet e miratuara dhe konsultuara në këtë periudhë.

2.6.9. Nëse disa nuk u publikuan, cilat janë arsyet?

Nuk ka raporte të papublikuara.

2.7 Vetëvlerësimi i institucionit në lidhje me Indeksin e cilësisë së performancës institucionale në përputhje me kërkesat e ligjit për njoftimin dhe konsultimin publik (Jepni informacion për rezultatin mesatar për të gjitha aktet e institucionit, subjekt të konsultimeve publike, bazuar në pikët e rezultateve në Shtojcën 5c)

3 **Sfidat dhe mundësitë për të ardhmen** *(Cilat janë sfidat kryesore në organizimin dhe zbatimin e konsultimeve në ministri dhe si duhet dhe do të adresohen ato në periudhën tjetër të raportimit?)*

Sfidë mbetet pjesëmarrja e publikut të gjerë dhe grupeve të interesit me komente në Regjistrin Elektronik të Njoftimeve dhe Konsultimeve Publike. Sugjerohet një fushatë komunikimi me prioritet të qartë për të rritur dukshmërinë dhe aksesin në këtë regjistër. Materialet objekt konsultimi ngarkohen në platformë, por duhet përshtatur aksesin vizual i materialeve pa qenë nevoja e shkarkimit (*download*). Në vijim të rritjes së dukshmërisë, do të duhet nxitja e grupeve të interesit, pjesëmarrës në tryezat e konsultimit publik që të ndajnë informacionit përmes platformave të tyre të komunikimit me qëllim informimin e grupeve të tyre të interesit.